

KËRKESË
Nr. 444/6, datë 22.4.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i Kopshtit nr. 37, ‘Bashkia Tiranë’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 25,247,313 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e trembëdhjetë) lekësh”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

- Për pasurinë “Objekt banimi”, është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Tiranë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 25,247,313 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Kastriot Gurra

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE E ASETVE DHE LICENCIMIT
DREJTORIA E PASURIVE TË PALUAJTSHME
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I KOPSHTIT 37”

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekare									Vlerësimet për shpronësim							Shënimet (Kufizime hipotekare, barri mbi pasuritë, etj.)		
	Emri	Adresa	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zonë kadastrale	Nr. i Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m ²)	Ndërtesat (m ²)	Volumi	Faqja	"Truall"			"Ndërtesat"						
													Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)				
	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T		
1	Alfred	Robert	Gjata	Tiranë	8380	3/144	Truall	496.00	496.00	0.00	20	19	377.00	66,969	25,247,313	0.00	0.00	0.00	25,247,313	Kontratë për vendosjen e hipotekës për garantimin e kreditit në dëshm nga banka apo institucion tjetër kredituese, siç është Union Bank, nr. 2/088, datë 20.11.2023.		
2	Bashkia Tiranë			Tiranë	8380	3/129	Truall	707.00	707.00	333.00	11	19	707.00	0.00	0.00	333.00	0.00	0.00	0.00	Kopshiti nr. 37, Objekti 2- katësh.		
Shuma													1,084.00					333.00			25,247,313	